



BIBLIOTEKA

854-1
V24.

PIRRO
VISARI



KORBI POLITIKAN



fabula

81H-1
n74.

PIRRO VISARI

**Korbi
politikan**



Fabula -

«Korbi politikan» është libri i katër i P. Visarit. Në konkursin kombëtar të 45 vjetorit të Çlirimit të Atdhdeut, ka marrë çmim të aytë për vëllimin me fabula «Këmborë për të gjithë».

Gjithashtu mjaft krijime të tjera si «Reformat e luanit» etj., janë vlerësuar me çmime në konkurset tradicionale të revistës «Hosteni».


Redaktorë:

SKËNDER DEMOLLI
PETRAQ KITA

Piktor:

ANASTAS KOSTANDINI

KLUBI I SHKRIMTARËVE
«BOTA E RE»



VOKALICA NE MESNATE

(*Fabula*)

K E Q V E N D O S J E

Bufi, si shef kuadri mjaft kompetent,
ariun e ngathët e vendosi postier.

Dhe lepurin veshgjatë pa u menduar fort
i është fletën e punës për hamall në port.

Ankesat, kuptohet, po vinin si breshër:
oriu i çonte letrat me një muaj vonesë.

Ndërsa lepuri mezi hiqej zvarrë në port,
më të shumtën e kohës qe me raport..

KORBI POLITIKAN

KEQAFEN DODZIE

MAJMUNI NË PEMË

Lodronte majmuni në barin e gjelbër,
s'u ngop e vendosi të ngjitej në pemë.

Dhe kapej në degë me dhëmbë e khetër,
trungu rrëzonte gjethet e vjetër...

Elefandi e shihte me nge dhe kureshtje,
pastaj tundi feçkën, foli me vete:

— Sa më lart të ngjitesh në pemë, o mik,
prapanikja të del, më tepër açik.

KORRI POUTKAN
PIRRO VISARI

MARRËZIA E PULËS

Një pulë e urtë sa më s'ka,
ngujuar mbi vezë në kotec,
me lafshën kapitur, mbi tra,
një gjel hijerëndë kish shef.

Dhe zëri s'i ndihej gjëkundi,
veç çastin kur shpejt bënte vezën.
- Ç'më duhet, - thoshte, - debati,
se shefi ta bëka të zezen...

Kështu e shtyu me vite.
Dikur i shkrepi në kokë:
- A s'dola njëherë shëtitje!
Shkojmë apo jo në Evropë!

KORBI POLITIKAN

Dhe ecte në rrugë me qibër,
dhe kokën s'ë kthente nga pas.
Një rrul i hipi përsipër,
e bëri si petull me vaj.

Pa foli e gjora, së fundi;
- Ç'mu desh, moj motra, ky qejf?!
Të gjallë në dhe më nguli,
ky qënka, ç'na qënka pér shef!

HAKIMIKA E GOMARINI

BISHTI I DHISE

Dhia i pa bishtin deles njëherë,
kur i mbeti ngritur diku në një ferrë.

- Pu, pu, ç'më panë sytë! Skandal i padëgjuar!
Ti qënke se ç'qënke, thëngjill i mbuluar!

Delja blegériu: - Pusho, moj gjynahqare!
Ti bishtin e ke dredhur, mes ditës, ashiqare.

Mbi gur kërceu dhia: - Ç'akuzë pa lezet!
Unë jam artiste dhe merrem me balet.

KORBI POLITIKAN

HAKMARRJA E GOMARIT

Luani, njëherë,
u sëmur rëndë.
Shtatë palë ethe,
e dridhin nga koka në këmbët.

Gjithë kafshët e pyllit,
i shkuan vizitë, varg.
Një gomar, u nis edhe ai

pas berihajt...

Kur pa luanin e leqendisur,
mendoi papritur:
me ç'tregojnë bathët
s'e ka të gjatë

ky tiran pa shpirt,

Gjithë jetën kam rrojtur

me frikën e tij.

Bile dhe në dasmë kur më ftoi,
(ku shkova pa asnjë dëshirë)
më vuri të mbaja ujë

për mysafirët...

Përse të mos ia kthej

me të njëjtën monedhë?

...Dhe ngriti bishtin,

e ngriti këmbët:

PIRRO VISARI

Luanit ia përshesti me thundër dhëmbët!

Nuk shkuan veçse pak ditë
dhe luani u shërua papritur!

... Alarm!

Veshgjatin e thiri me ferman:

- Shpjegohu pak, mik i vyer:
për këta dhëmbë të thyer?

Gomari,

gjoja e ndjeu veten të fyer:

- Imzot mbret!

Unë për ty kam patur

gjithmonë më të madhin
respekt!

Por, kisha dëgjuar

se thundra ime bën mrekullira.

Pyet po deshe, për këtë flet tërë mbretëria.

Ndaj ta kreva atë shërbim

me aq dëshirë.

Se e vërteta është

që pas terapisë së shkelmit në nofull,

u bëre qiqër... e arirë.

... Ndërsa me vete thosh qyqari:

- Të bëja mrekullira,

(djall, o punë!)

tani mbi varrin tënd,

barin jeshil

do e kullosja unë...

KORBI POLITIKAN

METAMORFOZA E KOKËS

Një mace tinzare, rrëmbeu e shpejtë,
një kokë të pjekur prej tavës së nxeh të.

Dhe foli bregores tek rrënja e fikut:
- Ç'më ngjake or' mik, si kokë akademiku!

Në furren shovene i djegur, si sërb;
bota thotë ç'thotë, ti avazin tënd!

... Pastaj i shkundi trutë, i hëngri me lezet:
- Tani, o kokoroç, me mercenarin ngjet!

PIRRO VISARI

... U erdhi radha syve, të fikur e pa dritë:
- Homerin mos lakmo, s'i ngjet në asnje pikë!

Më shumë më kujton kur të shoh përpara,
një poet oborri që thur hosanara...

... Ngushëllahu kokë! Po të pret kanali!
Më tepër tani, nuk ka as vasali...

KORBI POLITIKAN

LIRRIQ VITSHARI

PULA NË OBORR TË TJETRIT

Këndesi po shëtiste oborrit madhështor
dhe syçkat i lëvizte, ashik, si perandor.

Tek kopshti përkarshi, pa me kërshëri,
një pulë bukuroshe, të bukur si perri.

Zërin e pastroi dhe lafshën ndëzi flakë,
si solist në opera, këndoi plot me afsh.

Pula e mahnitur nga kjo serenatë,
e kaloi gardhin dhe i qaset pranë.

PIRRO VISARI

CHAL ME PUS

Këndesi hapi sytë e mbyllur me lezet:
pa se ish nga pulat që kishte në kote!

Shkundi puplat hidhur dhe u qa këndesi:
- Më e kolme dukeshe në oborr të tjetrit!

KORBI POLITIKAN

CJAPI NË PUS

Cjapi zbriste malit,

me kokë përpjetë.

Ra në pus zavalli,

në mes ujit mbeti.

Ndonëse në hall,

po shikonte veten:

- Jam i bukur, - tha

hajde, hajde, ç'mjekër!

PIRRO VISARI

Do bëj një kërkesë,
(sonte, natyrisht),
do vishem patjetër
dhe të bëhem prift.

Ujku, që dëgjonte,
zu qeshi me lot:
- Rason ta jap unë,
të bëhesh chespot...



KORBI POLITIKAN

SPECIALIZIMI I GALLOFIT

Pranë trungut të një rrapi,
prerë rrafsh si tavolinë,
bënte mbledhje komisionin.
Sekretar: një gardelinë.

Kryetari e merr fjalën:
- Pra fillojmë diskutimet,
Kush mendoni që të dalë,
jashtë pyllit për studime?

- Me që pylli ka nevojë
për sistem, planimetri,
unë bletën propozoj,
tha një gjel me urtësi.

- Punëtore e mbaruar,
tek ajo e ktheu mbrapa.
Nuk le vend për të dyshuar,
nga të gjithë më e aftë,

Por, u ngrit një buf i mplakur

(pupla s'kishte hiç në kokë).

Sytë fort i mbante hapur,

çeli sqepin si më poshtë:

- Mund të jetë punëtore,
veç të shohim dhe parimet,
se në pite dhe në hoje,
nga kubizmi ka ndikime!

Kam dhe unë një mendim:

Sekretar! Shëno në letër!

Kandidat, pa diskutim,

veç gallofit nuk ka tjetër!

Argumentet i kam lumë,
por dëgjoni vetëm tre:
Një-gallofi jeton shumë,
sjell kursime në buxhet...

KORBI POLITIKAN

MIRKO VIZARI

Paraqitjen e ka hak,
i zi sterrë, madhështor.

Ngjan i veshur si me frak,
dukët si ambasador.

Po u them e një sekret,
argument me rëndësi:
Tre-gallofi tani shpejt,
me skifterin bën krushqi...

... U peshuan argumentet,
me kandar të farmacistit.
Më i rëndë në peshore,
vjen i treti natyrisht.

PIRRO VISARI

TRANSFERIMI I QYQES

Shkuan muaj, shkuan mote,
vjen gallofi nga studimet.
Veshur, njeshur, sipas modës,
me ca lecka në valixhe.

Dhe së pari, majë lisit,
nis folënë e mbledh shkarpa.
I ve shtrembër e rrëmujë,
ca të vogla e ca të gjata.

... Mblidhen kafshë, mblidhen shpendë,
tallen hichur që përdhe:
- S'je për vete, derdimen,
prit pastaj të bësh për ne!

1988

KORBI POLITIKAN

TRANSFERIMI I QYQES

Në pyll u hap lajmi si vetëtimë:
qyqja e vendosur kërkon transferim!

U gëzuan shpesët, s'i thonë shaka,
se vezët e saj i ngrohnin ata,

Tak ! Tak! - qukapiku, trokiti me ndrojtje;
- Ashtu e kështu, dëgjuam zotrote!

PIRRO VISARI

- As topi s'e luan, - tha qyqja ngrefosur,
foleja në glasa më është djallosur.

Në pyllin ku shkoj, folenë patjetër,
të re do e ngre, si pikën e vesësl

Qesh qykapiku: - Ngado që të vesh,
«mullirin» me vete sërisht do ta kesh...

KORBI POLITIKAN

KARAKTERISTIKA E BREŠHKËS

Breshka si breshka, e hijte këmbën zvarrë,
puna zinte punën edhe bëhej mal.

E bukura ndodhi prej ditësh një ditë,
kur kërkuan t'i bëhej karakteristikë.

Karakteristika iu bë në kohë rekord:
- I gjithë kolektivi, breshkën e do fort!

E dashur me shokët, e thjeshtë, praktike,
është organizatore, e shpejtë, dinamike!

... Qëllimi kuptohet lehtë, nuk do shumë mend:
për ta hequr qafe në një tjetër vend.

1985

PIRRO VISARI

B A N K E T I

Një goxha ujk me syrin pishë,
në mes të pyllit jepte banket.

Uiski skocez me bajame të kripura,
pinte me të dhe një sheleg.

Kristali i gotave lodronte me rrezet,
më tej shushurinte i qetë një lumë.
Ujku, i menduar, ngrinte shëndete:
- Pi qerrata, se qeras unë!

Pemët duartrokisnin gjethet-pëllëmbë,
koncert cicërimash. Skenë idilike.
Ujku pareshtur vriste mendjen,
si ta hante qingjin

në mënyrë më demokratike.

KORBI POLITIKAN

PËRSE BILBILI KENDON SHUME

Bilbili, një dorë me pendë,
këndonte mes gjethesh një ditë.
Me zérin kumbues të ëmbël
dhe pyllin e mbushte me dritë.

Trumcaku dëgjonte në ferra
dhe foli menduar ca fjalë:
- Bilbil! Të iku tyjeta:
këndo e këndo si i marrë!

- Të shkurtër e kam jetën unë,
të shkurtër sa rrallë zog tjëtër.
Ndaj ngutem në këngë kaq shumë
se dua të them sa më tepër.

PIRRO - VISARI

MAÇOKU ME ZILE

Maçoku, i akuzuar publikisht
për shkeljen e të drejtave kafshërore,
vendosi solemnisht
që për ca kohë
të mos e ruante më
dyqanin e ushqimores.

Një natë, të errët pus,
lukuni me minj
u vërsulën në raftet me oriz e sheqer
dhe bënë batërdinë në terr.
Por, njëri prej tyre,
rrëzoi në rrëmujë, qëllimi isht
disa shishe me vaj e verë
duke bërë fërtele
ca shokë
që xhamat i grinë nën vete...

KORBI POLITIKAN

Të nesërmen, pa gdhirë mirë,
miu provokator,
gjysëm i pirë
paraqitet në gjykatë
e me indinjatë
proteston për masakrën e bërë!
- Kërkojmë drejtësi, - tha -
kundër maçokut gjakatar.
(ndërkohë, nga mustaqet, i binin katranit
Pikat e vajit...)

Kur në mesnatë,
ne flnim si shqera,
maçoku la nam në dyqan
dhe për alibi,
vrau ca prej nesh
për të na akuzuar
se jemi thev e jep em forcide nebb
që u kapën me presh

PIRRO VISARI

KORRI POLITIKAN

Maçoku i gjorë,
pikë e vrer,

mjaulliti:

- Atë që s'e bëri dot La Fonteni i ngratë,
do e bëj vetë këtë radhë.

Dhe pa ngurim
vuri zilen në qafë.

- Tani besoj, - tha, -
e merrni vesh lehtë,
ku do jem
në çdo orë të natës e ditës.

Zgjidhje me ideale për ju
nuk mund të ketë.

Por që sot e fütje,
dyqanet
ruajini vetë!

KORBI POLITIKAN

BRETKOSA MODERNE

Këneta e fjetur u zgjua prej dritës,
sikëlqente mbi ujrat një petromaks.
U turren bretkosat të kapnin mizat,
por binin tek rrjeta e ngritur për lak.

Kërçenin, përpinqeshin të dilni nga rrjeta,
veç kënbët u ngeçnin tek syhet e saj.
Nga klithmat e tyre gjëmonte këneta:
ë dënn që i priste tigani me vaj.

Kur ja, që nga uji, kérceu pa frikë
në rrjetë një bretkosë, me shpejtësi.
Të tjerat i thanë: - Ç'bën moj afikë?
Ku vemi të gjiltha, besojmë e di.

SHYQYRI I PIRRO VISARI

Përgjigjet bretkosa: - Mos prishni qederin!
Moderne kam qënë dhe jam përsëri.
Shyqyr që po shkojmë një herë jashtë shtetit,
të tjerat për mua s'kanë rëndësi!

KÖRBI POLITIKAN

MACIV OAMI

FTESA E DHELPRES

Ky lejleku, përsëri,
dhelprën ftoi në banket.
Nxorri gjellë, gjithë c'kish,
drekë shtruar si për mbret.

Veçse dhelpra turpëruar,
nuk pranon të mbetet mbrapa:
- E pohoj se jam gabuar,
kur të prita, si tek fabula...

Dhe lejleku, mysafir,
kthen vizitën tek mikesha.
Gjellët varg, mezet zinxhir,
shtron në sofër sëonte dhelpra.

HOBRI FORTIHAM
PIRRO VISARI

NUODOKA I AMITRINUSA

Por lejleku rri mérzitur,
pérplas sqepin nëpër pjata:

- Eh, moj dhelpér en bezdisur,
kësaj radhe ç'borxh të pata?!

- S'të kam faj, o lum vëllai,
këto enë kish dyqani.
E kush pyet sot përtregun?
Në global e bëjnë planin...

1987

KORBI POLITIKAN

AUTOKRITIKA E KROKODILIT

Krokodili qau me shtatë palë lot,
kur gëlltiti dhinë. Thanë kafshët: - Autokritikë e
pa fjalë, por amë, me ngashërimë.
fortë,

Në mëngjesin e së nesërmes,
u dëgjua një blegërimë e mjerë
dhe kërcitja e nofullave
sipas stilit të vjetër.

Krokodili përgatitej shpirtërisht,
për të bërë autokritikën tjetër.

PIRRO VISARI

MAJMUNI DHE REKLAMA

Majmuni kalonte përmes
ndërtesave, të larta si shtizë.
Befas, qëndroi tek një shesh
ku reklamat të prishnin nga sytë.

I pa me kurrestje e me nge,
pa pyetur për shiun që binte.
Reklamat lëshonin rrufe,
me drita të forta si blice.

KORBI POLITIKAN

WIMINI DHE REKLAMA

Së fundi mes shiut pa,
një femër në reklamë, lakuq,
Majmuni kroi leshin në bark
dhe ulet ta shohë në bisht.

Nën shiun që binte rrëke,
murmuriti dikur i menduar:
- Të ishte verë, moj e gjorë, hajqe de!
Por po deshe, të jap ca lesh hua..,

PIRRO VISARI

ZHURMË NË QIELL

Yjet u zunë një natë në qieLL
dhe rrezet i shkulnin njëri-tjetrit
si flokët gratë.

Arrusha e Madhe po rrihte të Voglën,
Afërdita çirrej e bënte shamatë.

Pas pak doli hëna, e zbehtë, e frikur:
- Më thoni ç'ka ngjarë, vëllezër e motra?
Nga zhurma juaj më doli çhe gjumi.
Mos «Lufta e yjeve» plasi së fundi?

U përgjigj një ylluc që rrinte mënjanë:
- Ç'është e vërteta, sa erdhi një lajm:
në tokë paska folur një intrigant.

KORBI POLITIKAN

CJAPI DHE PROFESORI

Shkonin sëbashku mes pyllit të dendur
me ferra e driza, si vjershë hermetike,
profesor i thinjur, si çele, hijerëndë
dhe para tij një cjap, me pamje akademike.

Kur ja, u çorr cjapi me sa kishte në kokë
se mjekrra i ngeli varur në ferrë.
I lutet profesorit, në gjunjë, përtokë:
- T'u bëfsha kurban, dhuroma ti mjekrrën!

A mundem të dal, kështu për ibret,
mes dhive të tufës, unë cjapi ashik?
Profesori heshti, një hop u step
dhe shkuli të vëtën: - Ta falat or mik!

PIRRO VISARI

Kur dolën prej pyllit, rrugët u ndanë.
Cjapi u nis për në stan madhështor
dhe tjetri ecte i mbushur me miza:
- C'do thonë kolegët e mij profesorë?

Po fundja po u them, për modë e preva;
vendosa të rinovohem dikur edhe unë!
Veç shkuan pak javë dhe pyllit me ferra,
profesori nxitonëtë në rrugë e pa rrugë.

Takohet me cjanin tek shkëmbi mbi stan
(Përtej ashiku me dhëmbët si brisk)
- Të erdha o mik dhe unë për hall,
se kohët e fundit e kam punën pisk.

KORBI POLITIKAN

Më vunë përpara në radio e gazeta,
së gjoja kam mbetur mbrapa nga bota.
Po fajin mendoj ma pati veç mjekrra,
të tjerat për mua janë fjalë e profka.

Pra kthema të lutem, ti mjekrrën e bardhë,
ti mjekrrën e mençur ma kthe përsëri!
... Cjapi vërriti dhe profesorit përpara,
i lëshoi të ngrohta tre kakërdhi:

- Se ç'flasin të tjerët dhe mua më thanë
dhe hallin ta qaj, o mik i vjetër.
Por gjëja e falur nuk kthehet më prapë,
cjapi mes dhive nuk del dot pa mjekërr!

PIRRO VISARI

SHKONIM I MUNDUR

Nuk di të kujtohet, kur shkonim mes pyllit,
ti ecje mbas meje kurioz në çdo vend.
Dhe shihje rruazat që bëja me kallëp,
Ndaj stilin ma vadhe... Të bie ndër mend?

KORBI POLITIKAN

RRËFIMI I KËNDESIT

Eh, artit ç'iu qepa me bukë në trastë!
Me zërin e kthjellët gris cipën e natës,

Pa çka se kantatën e kam identike,
çdo ditë e natë, çdo dimër e verë.
E dinë kritikët që njohin muzikën:
bëj variacione mbi të njëjtën temë.

KOKRI PIRRO
PIRRO VISARI

Shiko si bëjën që më këndoj
Këndoja tek avllia, tek gardhi, çatia,
këndoja me sy mbyllur, me afsh e lezet.
Nga ndrojtja do thoni, a modestia?
Kjo gjë deri sot ka mbetur sekret.

Këndoja e rrah krahët, por ndjehem i gjorë
Dhe sytë i mbyll se s'kam spëktatorë.

KORBI POLITIKAN

MBAS SYRIT TË BUKUR

Syrit të bukur, me qerpikë të gjatë,
goja i pëshpëriti me psherëtimë:

- Në bebëzën tënde të errët si natë,
një diell behari fshihet, në çdo stinë.

Balli u mvrejt kur dëgjoi ligjëratën,
rrudhat i mblodhi e foli menduar:

- Syri vërtet mund të jetë i bukur,
por ç'kam dhe unë brenda, duhet shikuar...

PIRRO VISARI

DY BINJAKËT

Miu i zyrave vendosi të vinte në plazh
(megjithëse prej natyre qe i zi)
dhe me që i dukej vetja i madh,
vetëm me elefantin
zuri shoqëri.

Një ditë të bukur,
kur miu po thekej në diell,
elefanti hyri ngadalë në det,
por pas pak
dëgjoi britmën e miut
që ngrihej në qiell:
- Elefant! Vëlla!
Të lutem eja ca!

KORBI PÓLITIKAN

DA DINARIKET

Elefanti doli në zall
si një mal ngarkuar me re:
- Hë more, ç'djallin ke?
Apo mos ndoshta të mérziti vëtmia?

U përgjigji miu me dorën mbi sy:
- Jo, por nga që jemi binjakë,
tashë mos kush e di,
kishe veshur mbathjet e mia.

PIRRO VISARI

MAÇOKU KËRKON

Miu hëngri një libër të vjetër filozofie
dhe u shtri ta hopenste me nge nën hije.

Mendime të çuditshme po i vinin në kokë:
- Sa lart e mbajnë veten disa filozofë!

U thinjën mjekrrat për një libër tërë jetën,
kur unë e hëngrat brenda tre netëshl

KORBI POLITIKAN

MAGJUJA KERKON

... Maçoku që e ndiqte me vëmendje nga larg,
ju afroa rrëshqanthi, kobash e tinzar.

Me shpejtësi kërceu mbi miun e dremitur
dhe bishtin e gjatë duke i kollofitur,

Pas pak, filloi të mjaullijë nëpër oborre:
- Kërkoj edhe unë gradë shkencore!

PIRRO VISARI

VOKALICA NË MESNATE

Pylli po bënte gjumin më të thelle,

kur befas, buçiti një ulurimë.

U zgjuan kafshët me tmerrin në zemër,

lepurit iu lagën këmbët në lëndinë.

- Do jetë luani, - u hoah çakalli, -

s'u ngop as natën ky gjakatar!

- Është gomari, - u përgjigj kali, -

bën vokalica pér këngëtar...

- Të rrojë pra arti, - foli trishtili, -

talenti siç duket po shkon tek të marrët;

në kore të tillë zëri i bilbilit,

nuk ka si të jetë violinë e parë.

1988

KORBI POLITIKAN

EZÖPI DHE GOMARI

Kur Ezopi shëtiste një ditë,
përpara i doli gomari.
Me zemërim nisi t'i fliste,
bile, deshi që ta tallë:

- Unë nuk shquhem për mëndjemprehtë
dhe as për veshët elegantë,
por ç'ke xhanëm që s'më le të qetë,
sikur të kam vrarë tét atë!

I pranojmë një çast ato që thua ti
dhe fabulat zeri se kanë vlerë.
Veç historia nesër ç'do thotë për ty?
U muarr tërë jetën me gomerë...

PIRRO VISARI

KENDRSI I RASAKALITËS

... Ezopi qeshi dhe u ndali në vend; ipob testos...
- Skom gjë me ty, o veshgjatë!
Ti ta kesh për nder që mbas emrit tënd,
ka fytyra njerëzish dhe jo kafshë.

Meqënëse të dy kemi një rrugë
dhe unë nojehem pak si i drobitur,
të lutem shumë rri pak urtë,
sa të të hipi përsipër.

KORBI POLITIKAN

KËNDESI | RASKAPITUR

Tek koteci dëgjoheshin rënkie
dhe pula e merakosur vrapi në oborr.
Në kashtë pa këndesin që përpélitej,
zgurdullonte sytë, shterngohej me zor.

Pula shkuli puplat e tronditir:

- Ç'është kjo hata e kjo gjëmë e zeze!
 - Ka filluar fushata elektorgje -

tha këndesi, -

dhe partia më kërkon që të bëj vezë.

PIRRO VISARI

KËLYSHI I UJKUT

Këlyshin e ujkut disa ditësh
e gjeti në udhë një tufë bagëtish.

I vogël qe, me sytë e pafajshëm
çhe delet filluan të lodrojnë me të.

Çobani aty afër, qeshi:
- Moj dele të shkreta!
Prisni dhe ca muaj,
sa t'i rriten kthetrat!

KORBI POLITIKAN

NJE BUQETË PËR LA FONTENIN

Gjinkalla tērē verës i ra fyellit nē një vrímë,
milingona punëtore mblodhi grurin pér nē dimër.

Dhe erdhi vjeshta me shira, pas saj dielli me
furtunë,
dëbora zbardhi malet rrrotull, mbuloi fushat me
gunë.

Priti milingona, priti, se mos vinte gjinkalla,
të trokiste tek dera, sa të tundej mëhalla.

Por muajt shkuan, rrodhën, si ujrat e një lumi,
kur pranvera lëshoi bisqe, u duk gjinkalla së fundi.

PIRRO VISARI

Fytyra i rrëzëllinte, mend pëlciste nga shëndeti,
veshur sipas modës. Milingona, gojëhapur mbeti.

Ĝjinkalla buzëqeshi: - Tungjatjeta, moj mikeshë,
jo çdo gjë fitohet me punë e me djersë!

Për talentin që pata, më morën në Ansambël.
Brodha... E ku nuk brodha? Shkova deri në Francë.

Për kortezi shkova dhe tek varri i La Fontenit,
një tufë lulesh vendosa, si respekt për të ndjerin.

Te koka i përshpërita: Eh, kohët kanë ndryshuar,
se çmund të bëjë miku, këtë s'e kishë menduar...

KORBI POLITIKAN

PARADOKSI I DHELPRËS

Shtrembër le të rrimë, por të flasim drejt:
për mua rrëfehen përralla me mbret!

Thonë sikur s'lashë asnjë pulë në këmbë,
Eh, t'i kisha ngrënë, të paktën në ëndërr!

Mëngjeseve pa gdhirë, kur dielli bën vetull,
shoh ndonjë fshatar me pulën nën sqetull.

PIRRO VISARI

Eshehur merr shtigjet e verbra drejt qytetit,
sic po duket puna, vejan mbet këndesi!

Pastaj më akuzojnë mua... S'i s'u vjen rëndë!
Paska më dhelpa nga unë, por janë me dy këmbë.

Mua më rroftë nami. (Ishalla rron dhe këndesi!)
Premtimet mbushin torbën dhe zbraket qymesi.

KORBI POLITIKAN

KORBI POLITIKAN

Në degën e lisit,

Një korb qëndronte hijerëndë,

Ca djathë

implakur i ligur.

si në fabulën e lashtë,
mbante në sqep

(e kish blerë në tregun e zi

e po matej ta hante me lezet.
me çmim të shtrenjtë)

Në degën tjetër,

një vandak me gazeta të ditës,
prisnin rradhën

mbas sillës së mëngjesit.

PIRRO VISARI

Pas erës
vjen nàrikulla e vjetër
dhe nis e cicëron si bilbil
me këtë stil:

- O korb krahëshkruar!
Ti Pavarot i paçmuar nga juritë!
Këto ditë
festoj ditëlindjen
ku pres tërë miqtë.
Ndaj një kasetë e mbushur
me këngët e tua brilante,
është feja vetë...

KORBI POLITIKAN

Korbi, kaloi djathin

- Këtë prallë bajate,
shite tek ndonjë kungull,
Jam rrahu tan me vaj e me uthull.

Pa kthe majat nga thembrat,
se mezi c'pres leri kanconetat,
tē lexoj gazetat!

... Dhe sérish morri djathin
nga khetra né sqep..;

PIRRO VISARI

Dhelpra, u step,
me bishtin në shalë,
por s'luajti vendit.
Diç u kujtua
e tha këto fjalë:

- Haje djathin, or mik
e të bëftë mirë.
Por me që ra fjala
a i dëgjove lajmet
e orës së fundit?
Në zgjedhjet e dyta,
pluraliste,
fitoi në mënyrë bindëse
partia ekologjike!

KORBI POLITIKAN

... Korbi zguradoloi sytë,
hapi sqepin
e krakaviti me zë të cjerrë:

- Për ndër! E dija unë!
Me shfrytëzimin barbar të pylit
e ndotjen pa kriter,
kështu do bitisej kjo punë...»

Dhelpa, ndérkohë,
s'e la djathin të binte përdhe...
Pastaj përshëndeti;

PIRRO VISARI

- Politikan i shquar!
Tungjatjeta!
Unë po shkoj tani
se kam ca halle të tjera
më konkrete
që lidhen me barkologjinë.
(ky djathi yt qënka shëllirë,
u dogja për ujë).

Ti ndërkaq,
mos e bëj bujë.
Përfito nga asistenca.

Ver kusinë
dhe atë dengun me gazeta
zjeje mirë e mirë
e piye lëngun
tri herë në ditë.

1991



VRAPPI KERMILLIT

(*Mikro-fabula*)

FIRRO VISARI

KËMBORË PËR TË GJITHË

Në stan, bariu i urtë,
zile solli për të gjithë.
Pas qafës ua varri në tufë,
dikujt këmborë, tjetrit një zilkë.

Dhe kur kopeja rrjedh në pllajë,
kumbon sinfonia baritore,
por kurrë nuk ndodh që këmbora e madhe
të mbytë zërin e ziles së vogël...

NË SHKRETËTIRE

Në shkretëtirë u ngrit vapori.
I fjalës së fundit-komoditeti.

Tani,
filloi të vriste mendjen konstruktori,
si mund të sillte aty
detin.

KORBI POLITIKAN

NËN SQETULL

Ngriti zhivën termomerti
dhe fodull u mburr me sqimë:
- Jam i shpejtë si askush tjetër,
rekordmen në shkallëzime!

Dora që e vuri,
pasi e shkundi,
ia ktheu plot:

- Mos u mburr kot!
Pa u futur nën sqetull,
ti nuk rron dot!

PIRRO VISARI

HUMANIZËM

- Jam human, -
tha litari, -
jap lakun falas, pa kushte,
ku mund të mbahet
në çastet e fundit
i varuri.

SHKENCA E KËRPUDHËS

Një kërpudhë,
në institutin e kërkimeve shkencore të pyllit,
punonte pa u lodhur,
me vëtmohim e përkushtim prometian.

Ndërkohë,
myku e kish pudrosur nga çdo anë
dhe shoshë e kishin bërë krimbat.

Teza e studimit:
- Si mund të shpiket penicilina.

KORBI POLITIKAN

K O N T R A T A

Në mesditën me diell të fortë,
bufi, nënshkroi konratën.
(Mbasi kishte prerë thonjtë
në darkë).

- Si kjo marrëveshje - tha - nuk ka të dytë.
Urdhëroni edhe thonjtë!

Për të nxjerrë sytë,

FILOZOFIA E PESHKUT

- Heshtja është flori, - tha i pari i peshqve,
Dhe heshtën ata prej brezit në brez,
Nga heshtja pastaj u zhvillua dhe truri,
ndaj, kur shajmë dikë, i themi:

= Trupeshk!

PIRRO VISARI

NGURIM PARA ÇARKUT

THUAJ PO TE DUASH

Çarkun duke parë,

miu ra në hall:

- Paska brenda djathë,
- bile, kaçkavall!

... Si qenka kjo punë,

more tungjatjeta!

Çarku paska anash

ca dhëmbë të mprehta!

Thuaj po të duash

se s'dijnë hile:

na afrojnë bukur,

çfarë duam në.

KORBI POLITIKAN

APOLOGJIA E KAMELEONIT

Erdhi pranvera,
Gjethet u jeshiluan krejt.
Dhe kameleoni, si ngahera,
lëkurën përshtati, për dreq.

- Parimet i ruaj, - tha, - dhe tundi bishtin,
ato ngjyrosen sipas stinës.
Didaktikë. Evolucion. Mendime,
Gabime dhe bëjmë, veç kemi kurajo,
në kohën e duhur të bëjmë ndryshime,

PIRRO VISARI

MODESTI

Leshtori shkoi tek berberët:
- Qethmëni, - tha, - si gjithë të tjerët.

Qerosi i ngratë pa hezitime,
grisi kapelen e re kur i doli një qime.

KORBI POLITIKAN

VARIACIONE MBI FIKUN

MË MIRE KËSHTU

Kur fiku

tha: ra nga fiku,

- Më mirë kështu
se sa të më kish ngrënë
të papjekur

miku.

SHFAJESIM:

Edhe

kur fiku

ra vetë nga fiku

tha:

- Ma pati fajin miku.

PIRRO VISARI

FORMALIZEM

Kërmilli tek muri tha me dihatje:

- Ç'guackë që kam në formë galaktike!

Dhe thonë se forma shkon mbas përmbajtjes...

Unë hapat në tokë i hedh milimetrike.

MARSHIMI I LUGEVE

Një mëngjesi me mjegull, të turbullt.

u hap lajmi se deti ú bë kos .

U nisën lugët në marrshim,

grumbuj-grumbuj

dhe nga brigjet me vërtik hidheshin përposh.

Dallgët me ujë të kripur dhe lëmizhde
nuk dihet ku i nxorrën, në cilat brigje.

KORBI POLITIKAN

KUJTESE PER FLUTUREN

- Moj flutur e bukur,
që vallzon sipër lulesh
më aq hir dhe finesë!

Vëri vëth në veshë këto dy fjalë,
tha trandafili me faqet purpur:

- Mos harro kurrë
që nga krimbi ke dalë.

PIRRO VISARI

FILLOZOFIA E PAPAGALLIT

- Të flasim! Të flasim! Të flasim! -
tha papagalli
dhe mësoi me zë të çjerrë disa fjalë.
Por e folura e tij ishte veç imitim
dhe brenda nuk kishte mendim të gjallë...

PESHIM I VESHTIRE

Kandari që peshon të tjerët
me egzigjencë e saktësi,
e ka vështirë të peshojë veten
dhe vlerën vetes nuk ia di.



REFORMAT E LUANIT

(*Poemë*)

PIRRO VISARI

REFORMAT E LUANIT

Në xhunglën e koklavitur,
diku në Afrikë,
Luani i dobësuar nga gjuetitë e lodhshme
vendosi
të bëjë lejën e zakonshme
të vitit.

Pa zbardhur mirë dita,
pa u venitur ylli i mëngjesit,
nën shkrepëtimë blicesh, fotoreporterësh,
mblodhi gjithë kafshët
dhe u tha në përshëndetje:

KORBI POLITIKAN

- Shtetas të nderuar!
e morrët vesh, besoj e keni dëgjuar
që turist do të dal

e pyjet do të bërdh.
Jo vetëm për lejë, siç e dini,
por edhe për të parë

e sjellë
me të rejat e qytetërimit...

Por,
me që mungesa ime
mund të shërbejë
si shkak për trazira e përgojime,
URDHËROJ:

gjithë kafshëve
tu vihet nga një dryn
në gojë!

PIRRO VISARI

Përjashtohet
nga kjo pikë e urdhërit,
tigri si komandant i ushtrisë!
Hijena, si ministre e kulturës,
(për t'uua bërë jetën
më të këndshme)

dhe dhelpa
si ministre e brendshme!
Ariu dhe gjithë skota
e tij,
të marrë masa të plota
për të ruajtur rendin
dhe qetësinë.

Hë, se për pak desh harrova:
drynat janë tepër të sigurtë,
nga ata të kohës së
Luftës së Dytë...

KORBI POLITIKAN

Lirohen e shterngohen

me një burrmë

pa fund,

(Si në çdo pikë

edhe këtu ka tolerancë...)

Të jemi të qartë!

Kjo është një masë

paraprake

që s'e cënon aspak demokracinë.

Se ndryshe, opozita,

do bënte shumë fjalë,

duke përfituar

nga mungesa ime.

PIRRO VISARI

... Hajde, pra!
Ç'prisni?
Duartrokisni!

... Luani u largua
mes brohoritjeve frenetike
(ë tigrat, ariut dhe hijenës.
Aq sa gjethet e verdhë
ranë
nga pemët.

... U vunë drynët
në gojën e çdo kafshe.
Në pyll ra qetësia e frikshme,
Por,

KORBI POLITIKAN

edhe pa «ustanë» e vet,
tigri
e zëvendësonte
me dinjitet:
vriste e priste!

Kafshët e gjora,
nga që s'hapnin dot gojën,
u ligën dhe u thanë,
sa brinjët u dukeshin fisarmonikë,

Shumë prej tyre ranë
e më s'u ngritën.
C'linte tigri ditës
plotësonte hijena natën
pa qibër.

PIRRO VISARI

U hoqën javët zvarrë.
Erdhi dita
të kthehej luani nga leja.

Në peron,
vendoset garda në rrjesht.
Dhe ja,
në horizont,
u duk lokomotiva
ku lëkundej si flamur i verdhë
krifa vigane e luaniit...

Ushtuan trumpetat
me bronxet e verdha.
Luani zbriti shkallët
madhështor.
Buçitën bateritë
ghe tigri u çorr;

KORBI POLITIKAN

- Për ndër, armë!
Zoti President!
Ju raportoj
se çdo gjë është në rregull...
Në shtet
ka mbretëruar
qetësia,
si pasojë e urtësisë tuaj
dhe e urdhërave të mia...

PIRRO VISARI

... Ndërkaq,
mënjanë i tha dhelpës:

- Kërdinë keni bërë, të shkretën!
Ky tigri makut, si s'u ngop,
është dhjamur e bërë si top!

Po unë,
ç'do ha,
sot edhe mot?

Dhelpa, një hop,
mbeti e habitur,
pastaj ia ktheu shpejt e shpejt:

- Shkëlqesi e ndritur!
Si gjithmonë,
ke të drejtë!

KÓRBI POLITIKAN

Nga burime të sigurta kam mësuar
se tigri, nën rrogos, kundër jush ka punuar...
Por kafshët,
s'kanë gojë të flasin
e po pëlcasin nga marazi.

Unë, sa për vete,
(se them për justifikim),
kam ngrënë
ndonjë rabeckë e laraskë
a ndonjë krimb...
Më mirë thuaj, kam mbajtur ramazan.

Buçiti luani si uragan:
- Popull i gjorë!
Ju ka tarturuar një tiran
pa shpirt!

PIRRO VISARI

Po e marr vesh tanë
që tigri ka shirë siç desh
dhe qeverisjen e vendit
e ka bërë përshest!

Ky palo ministër pa vlerë,
që unë e ngrita dikur
nga balta,
me ca derdimenë të tjera
deshi,
të bëjë grusht shtetil!

Prandaj,
të varet!!!

KORBI PÓLITIKAN

Dhe nga ky çast solemn,
ministër të Mbrojtjes Kombëtare,
çakallin
e shpalli!
Ja se si e pëson,
kush cënون
ligjet e mia!

Të rrojë pra,
demokracia!

Të hiqen drynat!
Po të dojë,
çdokush mund të dëshmojë
për mizoritë e tigrat...

PIRRO VISARI

Një sihariq!
U kam sjellë reforma të reja
ngā jashtë:

Qytetarë miq!
Që sot e tutje
do të rroni
vetëm me kashtë!

Të ruajmë kullotat
nga naotja - dhe babëzitja.

Ndaj
me tela me gjëmba,
të krijohen bandustanë,
që të mos kaloni dot matanë...

KORBI POLITIKAN

Dhe që sejcili të shikojë
punën e vet,
në Kodin Penal po shtojmë një nen të ri,

modern:

Ndalohet qarkullimi
në grupe
nga dy e nga tre!

Kjo s'e cënon aspak
lirinë e fjalës
e të ndërgjegjes!


PIRRO VISARI

Kush të dojë
le të flasë
sa të mundë me vete,
por të mos i shqetësojë të tjerët...

Kështu forcohet rregulli e qetësia.

Të rrojë, pra,
DEMOKRACIA!

1989-1990




PËRMBAJTJA

	Faqe
Keqvendosje	5
Majmuni në pemë	6
Marrëzia e pulës	7
Bishti i dhisë	9
Hakmarrja e gomarit	10
Metamorfoza e kokës	12
Pula në oborr të tjetrit	14
Cjapi në pus	16
Specializimi i gallofit	18
Transferimi i qyqes	22
Karakteristika e breshkës	24
Banketi	25
Përse bilbili këndon shumë	26
Maçoku me zile	27
Bretkosa moderne	30
Ftesa e dhelprës	32
Autokritika e krokodilit	34
Majmuni dhe reklama	35
Zhurmë në qiell	37
Cjapi dhe profesori	38
Rrëfimi i këndesit	42
Mbas syrit të bukur	44
Dy binjakët	45
Maçoku kërkon	47

TABLE OF CONTENTS

Faqe

Vokalica në mesnatë	49
Ezopi dhe Gomari	50
Këndesi i raskapitür	52
Këlyshi i ujkut	53
Një buqetë për La Fontenin	54
Paradoksi i dhelprës	56
Korbi politikan	58
Këmborë për të gjithë	67
Në shkretëtirë	67
Nën sqetull	68
Humanizëm	69
Shkenca e kërpudhës	69
Kontrata	70
Filozofia e peshkut	70
Ngurim para çarkut	71
Apologjia e 'kameleonit	72
Modesti	73
Variacione mbi fikun	74
Formalizëm	75
Marshimi i lugëve	75
Kujtesë për fluturën	76
Filozofia e papagallit	77
Peshim i vështirë	77
Reforma e Luanit	81



LIBRA TË TJERË TË AUTORIT

"RRUGËT NUK FLENË"-Poezi-1978

"PLESHTI ME FRE"-Fabula-1986

"NESËR ËSHTË SOT"-Poezi-1990